



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr. 137

23 tetor

2012

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr. 93/2012 datë 4.10.2012	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shtetit të Kuvajtit për bashkëpunimin ligjor dhe gjyqësor në çështjet penale	7751
Ligj nr. 94/2012 datë 11.10.2012	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për zgjidhjen e borxhit të Republikës së Shqipërisë kundrejt Republikës së Maqedonisë, lidhur me shlyerjen e shumave në llogarinë e shkëmbimit të mallrave ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Ish-Republikës Federale Socialiste të Jugosllavisë.....	7768
Vendim i Kuvendit nr. 39/2012, datë 11.10.2012	Për zgjedhjen e zotit Hysen Osmanaj anëtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve	7771
Vendim i Kuvendit nr. 40/2012, datë 11.10.2012	Për zgjedhjen e zonjës Vera Shtjefni anëtare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve	7772
Vendim i Kuvendit nr. 41/2012, datë 11.10.2012	Për zgjedhjen e zonjës Albana Shtylla anëtare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve	7772
Vendim i Kuvendit nr. 42/2012, datë 11.10.2012	Për zgjedhjen e zotit Denar Biba anëtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve	7773
Vendim i Kuvendit nr. 43/2012, datë 11.10.2012	Për zgjedhjen e zotit Ilirian Muho anëtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve	7773
Vendim i Kuvendit nr. 44/2012, datë 11.10.2012	Për zgjedhjen e zotit Jani Jani anëtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve	7774

Vendim i Kuvendit nr. 45/2012, datë 11.10.2012	Për zgjedhjen e zonjës Lefterije Lleshi (Luzi) kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve	7774
Dekret nr. 7771 datë 1.10.2012	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	7775
Dekret nr. 7772 datë 1.10.2012	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare	7775
Dekret nr. 7773 datë 8.10.2012	Për lirim ambasadori nga detyra	7776
Dekret nr. 7774 datë 8.10.2012	Për emërimin e Rektorit të Akademisë së Arteve, Shkodër	7776
Dekret nr. 7780 datë 9.10.2012	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	7777
Dekret nr. 7781 datë 9.10.2012	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	7777
Dekret nr. 7782 datë 10.10.2012	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare	7778
Dekret nr. 7785 datë 12.10.2012	Për emërim ambasadori	7778
Udhëzim i MD dhe MF nr. 5341/5, datë 7.9.2012	Për miratimin e tarifave të shërbimit të Zyrave të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme	7779

LIGJ
Nr. 93/2012

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SHTETIT TË KUVAJTIT PËR
BASHKËPUNIMIN LIGJOR DHE GJYQËSOR NË ÇËSHTJET PENALE**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shtetit të Kuvajtit për bashkëpunimin ligjor dhe gjyqësor në çështjet penale.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 4.10.2012

**Shpallur me dekretin nr. 7794, datë 15.10.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

MARRËVESHJE

**MBI BASHKËPUNIMIN LIGJOR DHE GJYQËSOR NË ÇËSHTJET PENALE NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
SHTETIT TË KUVAJTIT**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe qeveria e shtetit të Kuvajtit (më poshtë të quajtura palët kontraktuese);

Me dëshirën për të nxitur bashkëpunimin e ndërsjellë ligjor dhe gjyqësor në çështjet penale, në frymën e respektit reciprok të parimeve të sovranitetit dhe të të drejtave të barabarta;

Duke pranuar nevojën për të lehtësuar, në nivelin më të lartë të mundur, ndihmën e ndërsjellë juridike, ekstradimin dhe transferimin e personave të dënuar;

kanë rënë dakord si më poshtë:

KAPITULLI I
NDIHMA E NDËRSJELLË JURIDIKE

Neni 1

Fusha e zbatimit

1. Sipas kësaj marrëveshjeje, palët kontraktuese i japin njëra-tjetrës, në nivelin më të lartë të mundur, ndihmë të ndërsjellë juridike në çështjet penale.



2. Palët kontraktuese shkëmbejnë informacion për vendimet e formës së prerë të dhëna kundër shtetasve të palës tjetër kontraktuese.

3. Për qëllimet e kësaj marrëveshjeje, ndihma e ndërsjellë juridike jepet pavarësisht nëse ndihma kërkohet ose duhet të jepet nga një gjykatë ose autoritet tjetër zyrtar.

4. Dispozitat e kësaj marrëveshjeje nuk cenojnë ligjet e zbatueshme të dy vendeve, të drejtat dhe detyrimet që lindin nga konventa dhe marrëveshje të tjera ndërkombëtare në të cilat ato janë palë.

5. Kjo marrëveshje zbatohet edhe për çdo kërkesë për ndihmë juridike në lidhje me veprimet ose mosveprimet e kryera para hyrjes së saj në fuqi.

Neni 2 Përkufizime

Për qëllimet e kësaj marrëveshjeje:

1. “Çështje penale” nënkupton hetimet, gjykimet ose procedime të tjera në lidhje me një vepër penale, të vendosura me ligj.

2. “Çështje penale” përfshin, gjithashtu, hetimet ose procedimet në lidhje me veprat penale mbi tatimet, detyrimet, doganat dhe transferimin ndërkombëtar të kapitalit ose pagesave.

3. “Ndihmë” përfshin:

a) masat për të lokalizuar, kufizuar, sekuestruar ose konfiskuar produktet dhe mjetet e veprës penale;

b) marrjen e provave dhe deklaratave të personave;

c) dhënien e informacionit, dokumenteve dhe të dhënave të tjera, duke përfshirë të dhënat penale dhe gjyqësore;

d) lokalizimin e personave dhe objekteve, duke përfshirë identifikimin e tyre;

e) kërkimin dhe konfiskimin;

f) dorëzimin e pronës, dhënien e objekteve të sekuestruara të provave materiale;

g) vënien në dispozicion të personave të ndaluar dhe të tjerëve për të dhënë prova ose për të ndihmuar hetimet;

h) dërgimin e dokumenteve, duke përfshirë dokumente që kërkojnë paraqitjen e personave; dhe

i) ndihmë tjetër në përputhje me objektivat e kësaj marrëveshjeje.

4. “Produkte të veprës penale” nënkupton çdo pasuri që ka rrjedhur ose është realizuar drejtpërdrejt ose tërthorazi nga një person nga një vepër penale ose vlera e një pasurie të tillë.

5. “Pasuri” përfshin paratë dhe të gjitha llojet e pasurisë së luajtshme ose të paluajtshme, të trupëzuara ose të patrupëzuara dhe përfshin çdo interes mbi këtë pasuri.

6. “Konfiskim” nënkupton çdo masë që çon në humbjen e pasurisë nga vendimi përfundimtar.

7. “Mjetet e veprës penale” nënkupton çdo pasuri që është përdorur ose synohet të jetë përdorur në lidhje me kryerjen e një vepre penale.

8. “Kufizim pasurie” nënkupton çdo masë për parandalimin e tregtimit ose transferimit ose shitjen e pasurisë.

Neni 3 Autoritetet qendrore

Palët kontraktuese kanë rënë dakord që Ministria e Drejtësisë e Republikës së Shqipërisë dhe Ministria e Drejtësisë e shtetit të Kuvajtit të kryejnë funksionet e autoriteteve kompetente të palëve kontraktuese.

Neni 4 Përmbajtja e kërkesave

1. Kërkesat për ndihmë sipas kësaj marrëveshjeje bëhen me shkrim. Megjithatë, në rrethana urgjente ose kur lejohet ndryshe nga pala e kërkuar, kërkesat mund të bëhen verbalisht, por konfirmohen me shkrim menjëherë më pas.

2. Kërkesat për ndihmë përfshijnë një deklaratë të:

a) Emrit të autoritetit kompetent që kryen hetimin ose procedimet me të cilat ka lidhje kërkesa;

b) Faktet përkatëse nën hetim ose procedime, duke përfshirë dispozitat e ligjit të zbatueshëm;

c) Qëllimin për të cilin është bërë kërkesa dhe natyrën e ndihmës së kërkuar;

d) Të dhëna të ndonjë procedure të veçantë ose kërkesë që pala kërkuese dëshiron të ndiqet;

e) Çdo afat kohor brenda të cilit dëshirohet pajtueshmëria me kërkesën;

f) Identiteti, kombësia dhe vendndodhja e personit ose personave që i nënshtrohen hetimit ose procedimeve;

g) Në rast të kërkesave për marrjen e provave ose kërkimit dhe konfiskimit, një deklaratë që tregon bazën për të besuar se provat mund të gjenden në juridiksionin e palës së kërkuar;

h) Në rast të kërkesave për marrjen e provave nga një person, një deklaratë, nëse kërkohen deklarata nën betim ose të pohuara, dhe një përshkrim të subjektit të provave ose deklaratës së kërkuar;

i) Në rastin e dhënies së provave materiale, letërkërkesa përcakton vendin në të cilin do të transmetohen provat materiale, çdo shqyrtim që duhet të kryhet dhe datën në të cilën do të kthehen provat materiale;

j) Nevojën, nëse ka, për fshehtësi dhe arsyet për këtë; dhe

k) Në rast të kërkesave për kufizim ose konfiskim të produkteve ose të mjeteve të veprës penale, kur është e mundur, përfshijnë sa më poshtë:

1) Një përshkrim të hollësishëm të produkteve ose të mjeteve, duke përfshirë vendndodhjen e tyre;

2) Një deklaratë që përshkruan arsyen për besim që paratë ose pasuria janë produkte ose mjete të veprës penale; dhe

3) Pala e kërkuar nuk refuzon ekzekutimin e kërkesës vetëm sepse nuk përfshin të gjithë informacionin sipas këtij neni, nëse mund të ekzekutohet ndryshe sipas ligjit të palës së kërkuar.

4) Nëse pala e kërkuar çmon se nevojitet informacion shtesë për të mundësuar trajtimin e kërkesës, ajo palë mund të kërkojë këtë informacion shtesë.

Neni 5 Ekzekutimi i kërkesës

1. Kërkesat për ndihmë ekzekutohen në përputhje me ligjin e palës së kërkuar dhe mund të ekzekutohen në çdo mënyrë të përcaktuar në kërkesë, nëse nuk është e papajtueshme me ligjin e palës së kërkuar.

2. Pala e kërkuar informon palën kërkuese për çdo rrethanë që mund të shkaktojë vonesë të konsiderueshme në ekzekutimin e kërkesës.

3. Pala e kërkuar informon menjëherë palën kërkuese për vendimin e palës së kërkuar për të mos u pajtuar plotësisht ose pjesërisht me kërkesën për ndihmë ose për të shtyrë ekzekutimin dhe jep arsyet për atë vendim.



Neni 6 Refuzimi i ndihmës

1. Pala e kërkuar mund të refuzojë ndihmën, nëse:
 - a) Ekzekutimi i kërkesës do të cenonte sovranitetin e saj, sigurinë, rendin publik (*ordre public*) ose interesa të tjerë thelbësorë;
 - b) Ekzekutimi i kërkesës do të ishte në kundërshtim me ligjin e brendshëm të palës së kërkuar;
 - c) Kërkesa kërkon kufizimin, sekuestrimin ose konfiskimin e produkteve ose të mjeteve të veprës penale, që, nëse do të kishte ndodhur brenda juridiksionit të palës së kërkuar, nuk do të kishte qenë krim në lidhje me të cilin mund të ishte bërë një urdhër konfiskimi;
 - d) Kërkesa ka lidhje me një veprë penale, ndjekja e së cilës në palën kërkuese do të ishte e papajtueshme me ligjin e palës së kërkuar mbi ndalimin e gjykimit dy herë për të njëjtën veprë penale (*ne bis in idem*).
2. Para refuzimit të miratimit të një kërkesë për ndihmë, pala e kërkuar vlerëson nëse ndihma mund të jepet në bazë të atyre kushteve që ajo çmon të nevojshme. Nëse pala kërkuese pranon ndihmën në bazë të kushteve, ajo pajtohet me to.

Neni 7 Transmetimi i dokumenteve dhe objekteve

1. Kur kërkesa për ndihmë ka lidhje me transmetimin e të dhënave dhe dokumenteve, pala e kërkuar mund të transmetojë kopje të vërtetuara të tyre, nëse pala kërkuese nuk kërkon shprehimisht ndryshe origjinalet.
2. Të dhënat ose dokumentet origjinale dhe objektet e transmetuara për palën kërkuese i kthehen palës së kërkuar sa më parë që të jetë e mundur, sipas kërkesës së kësaj të fundit.
3. Në masën që nuk ndalohet nga ligji i palës së kërkuar, dokumentet, objektet dhe të dhënat i transmetohen në një formë ose shoqërohen nga një vërtetim që mund të kërkohet nga pala kërkuese, me qëllim që t'i bëjë ato të pranueshme sipas ligjit të palës kërkuese.

Neni 8 Marrja e provave në palën e kërkuar

1. Një person, duke përfshirë një person nën arrest, të kërkuar për të dëshmuar dhe për të paraqitur dokumente, të dhëna ose materiale të tjera në palën e kërkuar, mund të thirret me fletëthirrje/urdhër arresti ose urdhër tjetër të një autoriteti kompetent, për t'u paraqitur dhe dëshmuar dhe paraqitur dokumente, të dhëna dhe materiale të tjera në përputhje me ligjin e palës së kërkuar.
2. Në bazë të ligjit të palës së kërkuar, komisionerët, përfaqësuesit e tjerë të palës kërkuese dhe personat përkatës në procedime në palën kërkuese, lejohen të jenë të pranishëm, kur provat merren në palën e kërkuar dhe të marrin pjesë në marrjen e këtyre provave.
3. E drejta për të marrë pjesë në marrjen e provave përfshin të drejtën e përfaqësuesit ligjor të pranishëm për të bërë pyetje. Personat e pranishëm në ekzekutimin e një kërkesë mund të lejohen të bëjnë një zbardhje të procesverbalit të procedimit dhe të përdorin mjete teknike për të bërë këtë zbardhje procesverbali, nëse lejohet nga gjykata ose autoriteti kompetent.

Neni 9

Disponueshmëria e personave për të dhënë dëshmi ose ndihmë

1. Një palë kërkuese mund të kërkojë që një person të vihet në dispozicion për të dëshmuar ose për të ndihmuar në një hetim.
2. Pala e kërkuar fton personin që të ndihmojë në hetim ose të paraqitet si dëshmitar në procedime dhe të kërkojë pëlqimin e atij personi për to. Ai person informohet për çdo shpenzim dhe shuma të pagueshme.

Neni 10

Vënia në dispozicion e personave të ndaluar për të dhënë dëshmi për të ndihmuar hetimin

1. Një person nën arrest në palën e kërkuar, me kërkesë të palës kërkuese, mund të transferohet përkohësisht në palën kërkuese për të ndihmuar në hetime ose procedime, me kusht që personi të japë pëlqimin për atë transferim dhe të mos ketë asnjë arsye penguese për transferimin e personit. Nëse personi kundërshton transferimin, zbatohet neni 8.
2. Kur personi i transferuar kërkohet të mbahet nën arrest sipas ligjit të palës së kërkuar, pala kërkuese e mban atë person nën arrest dhe e kthen personin nën arrest me përfundimin e ekzekutimit të kërkesës.
3. Kur dënimi i vendosur mbaron ose kur pala e kërkuar njofton palën kërkuese që personi i transferuar nuk kërkohet të mbahet më nën arrest, ai person do të lirohet dhe do të trajtohet si person i pranishëm në palën kërkuese sipas një kërkesë që kërkon pjesëmarrjen e atij personi.
4. Një i burgosur mund të mos transferohet, nëse ky transferim ka efektin e shtyrjes së kohëzgjatjes së burgimit të tij.

Neni 11

Ruajtja e sigurt

1. Një person i pranishëm në palën kërkuese, në përgjigje të një kërkesë që kërkon pjesëmarrjen e atij personi, nuk ndiqet penalisht, ndalohet ose i nënshtrohet ndonjë kufizimi tjetër të lirisë personale në territorin e asaj pale për çdo veprim ose mosveprim që ka paraprirë nisjen e atij personi nga pala e kërkuar, dhe ai person nuk do të jetë i detyruar të japë dëshmi në ndonjë procedim të ndryshëm nga procedimet me të cilat ka lidhje kërkesa.
2. Një person, i cili është i pranishëm në palën kërkuese me pëlqim, si rezultat i një kërkesë për pjesëmarrjen e personit për t'u përgjigjur para një autoriteti gjyqësor për çdo akt veprimi ose mosveprimi, nuk ndiqet penalisht ose nuk ndalohet, ose nuk i nënshtrohet ndonjë kufizimi tjetër të lirisë personale për aktet e veprimit ose mosveprimit, që kanë paraprirë nisjen e atij personi nga pala e kërkuar, të papërcaktuar në kërkesë.
3. Paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni nuk zbatohen më nëse një person, duke qenë i lirë të largohet nga pala kërkuese, nuk është larguar prej saj brenda një periudhe prej 30 ditësh, pasi të jetë njoftuar zyrtarisht se pjesëmarrja e tij nuk kërkohet më ose, pasi të jetë larguar nga ai territor, është kthyer vullnetarisht.
4. Çdo person që nuk mund të paraqitet në palën kërkuese mund të mos i nënshtrohet ndonjë sanksioni ose mase detyruese në palën e kërkuar.



Neni 12

Produktet dhe mjetet e veprës penale

1. Pala e kërkuar, me anë të një kërkesë, përpiqet të verifikojë nëse produktet ose mjetet e veprës penale ndodhen brenda juridiksionit të saj dhe njofton palën kërkuese për rezultatet e kërkimeve të saj.

2. Një kërkesë për ndihmë mund të bëhet në sigurimin e sekuestrimit ose konfiskimit të produkteve ose mjeteve të veprës penale. Kjo ndihmë jepet në përputhje me ligjin e palës së kërkuar me çdo lloj mjeti të përshtatshëm. Kjo mund të përfshijë dhënien e fuqisë së një urdhri të dhënë nga një gjykatë ose autoritet tjetër kompetent në palën kërkuese ose paraqitjen e një kërkesë pranë një autoriteti kompetent për qëllim të kërkimit të një urdhri sekuestrimi ose konfiskimi në palën e kërkuar.

3. Një kërkesë për ndihmë mund të bëhet për kufizimin e pasurisë për të garantuar mundësinë e përmbushjes së një urdhri për kompensimin e produkteve ose mjeteve.

4. Kur në palën e kërkuar janë marrë masa sipas një kërkesë për ndihmë sipas paragrafit 1 ose 2 të këtij neni dhe ka një interes të një pale të tretë në mirëbesim (*bona fide*), pala përkatëse informon palën tjetër sa më parë që të jetë e mundur.

Neni 13

Fshehtësia dhe kufizimi i përdorimit

1. Pala e kërkuar mund të kërkojë, pas konsultimit me palën kërkuese, që informacioni ose të dhënat e ofruara, ose burimi i këtij informacioni, ose i të dhënave të mbahet i fshehtë ose të zbulohet, ose të përdoret vetëm në bazë të afateve dhe kushteve që mund të përcaktojnë.

2. Pala e kërkuar, në shkallën e kërkuar, ruan të fshehtë një kërkesë, përmbajtjen e saj, dokumentet mbështetëse dhe çdo veprim të marrë sipas kërkesës, përveçse në shkallën e nevojshme për ta ekzekutuar atë.

3. Pala kërkuese nuk zbulon ose përdor informacion, ose prova të ofruara për qëllime të ndryshme nga ato të deklaruara në kërkesë, pa miratimin paraprak të palës së kërkuar.

Neni 14

Vërtetimi i dokumenteve

Të dhënat ose dokumentet e transmetuara sipas kësaj marrëveshjeje, nuk kërkojnë ndonjë formë vërtetimi, përveç asaj të përcaktuar në nenin 7.

Neni 15

Gjuha

Kërkesat dhe dokumentet mbështetëse shoqërohen nga një përkthim në një prej gjuhëve zyrtare të palës së kërkuar ose në gjuhën angleze.

Neni 16

Kostot

1. Pala e kërkuar përmbush kostot e ekzekutimit të kërkesës për ndihmë, përveç kur pala kërkuese përballon:

a) Shpenzimet e shoqëruara me transportimin e një personi për ose nga territori i palës së kërkuar, me kërkesë të palës kërkuese, dhe çdo pagesë ose shpenzim të pagueshëm për atë person, ndërsa në palën kërkuese sipas një kërkesë sipas neneve 9 ose 10 të kësaj marrëveshjeje; dhe

b) Shpenzimet dhe tarifatat e ekspertëve në palën e kërkuar ose në palën kërkuese.

2. Nëse bëhet e qartë se ekzekutimi i kërkesës kërkon shpenzime të një natyre të jashtëzakonshme, palët kontraktuese konsultohen për të përcaktuar termat dhe kushtet sipas të cilëve mund të jepet ndihma.

KAPITULLI II

EKSTRADIMI

Neni 17

Detyrimi për të ekstraduar

Secila palë bie dakord të ekstradojë te pala tjetër, sipas kërkesës dhe në bazë të dispozitave të kësaj marrëveshjeje, çdo person që kërkohet në palën kërkuese për ndjekje penale për një veprë penale të ekstradueshme ose për vendosjen, ose zbatimin e një dënimi në lidhje me atë veprë penale, nëse kjo veprë ishte kryer para ose pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

Neni 18

Veprat e ekstradueshme

1. Për qëllimet e kësaj marrëveshjeje, veprat penale të ekstradueshme janë veprat që janë të dënueshme sipas ligjeve të të dyja palëve me burgim ose heqje tjetër lirie për të paktën një periudhë prej një viti ose një periudhë më të gjatë.

2. Kur një kërkesë për ekstradim ka lidhje me një person, tashmë të dënuar për këtë veprë që kërkohet për zbatimin e një dënimi me burgim ose heqje tjetër lirie, ekstradimi do të jepet vetëm nëse një dënim me burgim prej të paktën gjashtë muajsh është vendosur në lidhje me një veprë penale të ekstradueshme.

Neni 19

Veprat penale fiskale

1. Për veprat në lidhje me taksat, detyrimet fiskale dhe taksat doganore, ekstradimi kryhet në përputhje me dispozitat e kësaj marrëveshjeje, vetëm nëse vepra e lartpërmendur korrespondon me një veprë të një natyre të ngjashme sipas ligjit të palës së kërkuar.

2. Një tentativë ose bashkëpunim për të kryer ose marrë pjesë në kryerjen e një vepre penale të ekstradueshme konsiderohet, gjithashtu, një veprë penale e ekstradueshme.

Neni 20

Vendi i kryerjes

1. Pala e kërkuar mund të refuzojë të ekstradojë një person të kërkuar për një veprë penale, që konsiderohet nga ligji i saj sikur të ishte kryer tërësisht ose pjesërisht në territorin e saj ose në një vend të trajtuar si territori i saj.

2. Kur vepra penale për të cilën kërkohet ekstradimi është kryer jashtë territorit të palës kërkuese, ekstradimi mund të refuzohet vetëm nëse ligji i palës së kërkuar nuk lejon ndjekjen penale për të njëjtën kategori veprash penale kur kryhen jashtë territorit të kësaj pale ose nuk lejon ekstradimin për veprën përkatëse.



Neni 21

Mosekstradimi i shtetasve

1. Shtetasit e secilës prej dy palëve kontraktuese nuk ekstradohen te pala tjetër kontraktuese. Në këtë rast, pala e kërkuar paraqet çështjen për ndjekje penale pranë autoritetit kompetent, nëse veprimi i kryer ose mosveprimi konsiderohet vepër penale sipas ligjit të palës së kërkuar.
2. Shtetësia përcaktohet në kohën e kryerjes së veprës penale.

Neni 22

Arsyet për refuzim

1. Ekstradimi mund të refuzohet:
 - a) Nëse vepra penale për të cilën kërkohet ekstradimi është një vepër politike ose e lidhur me një vepër politike. Në zbatim të kësaj marrëveshjeje, sa më poshtë, nuk konsiderohen si vepra politike:
 - i) sulmi kundër Presidentit, Zëvendëspresidentit ose Kryeministrit të secilës palë kontraktuese;
 - ii) vepra në lidhje me terrorizmin, duke përfshirë vrasjen, sulmin që shkakton lëndim fizik; rrëmbimin, pengmarrjen, vepra që përfshijnë dëm serioz ndaj pronës ose ndërprerje të shërbimeve publike dhe vepra në lidhje me armët e zjarrit ose armë të tjera, ose lëndë plasëse, ose substanca të rrezikshme;
 - iii) çdo vepër brenda objektivit të konventave ndërkombëtare në të cilat të dyja palët kontraktuese janë palë dhe që detyrojnë palët të japin ekstradim ose të ndjekin penalisht; ose
 - iv) çdo tentativë ose bashkëpunim për të kryer ose nxitur, ose marrë pjesë në kryerjen e ndonjë prej veprave të mësipërme.
 - b) “Nëse vepra penale për të cilën kërkohet ekstradimi është e dënueshme me vdekje, sipas ligjit të palës kërkuese”;
 - c) Nëse pala e kërkuar ka arsye kryesore për të besuar se një kërkesë për ekstradim është bërë për qëllim të ndjekjes penale ose dënimit të një personi për arsye të racës, fesë, shtetësisë, etnisë, origjinës, opinioneve politike, gjinisë ose statusit të atij personi, ose që pozicioni i atij personi mund të cenohet për ndonjë arsye tjetër.
2. Ekstradimi, gjithashtu, mund të refuzohet, nëse:
 - a) Personi që kërkohet të ekstradohet ka qenë më parë i gjykuar për të njëjtën vepër penale për të cilën kërkohet ekstradimi dhe është shpallur i pafajshëm ose është dënuar dhe ka plotësuar dënimin ose po e kryen atë;
 - b) Ekstradimi nuk jepet kur ndjekja penale ose zbatimi i dënimit për veprën penale për të cilën është kërkuar ekstradimi është parashkruar nga kalimi i kohës sipas ligjeve të palës kërkuese ose palës së kërkuar, kur ishte marrë kërkesa për ekstradim;
 - c) Vepra penale ishte kryer jashtë territorit të palës kërkuese nga një shtetas i një shteti të tretë dhe nëse ajo nuk është vepër penale sipas ligjit të palës së kërkuar;
 - d) Vepra për të cilën kërkohet ekstradimi ishte kryer në palën e kërkuar, me kusht që pala e kërkuar të ndjekë penalisht personin;
 - e) Një person ekstradimi i të cilit kërkohet, po hetohet ose gjykohet në palën e kërkuar për të njëjtën vepër penale për të cilën kërkohet ekstradimi; ose
 - f) Dënimi që mbetet për t'u kryer nga një person i dënuar për një vepër të ekstradueshme, është jo më pak se gjashtë muaj.

Neni 23

Transferimi i procedimeve

Kur pala e kërkuar refuzon një kërkesë për ekstradim për arsyet e përcaktuara sipas kësaj marrëveshjeje, pala e kërkuar ndërmerr, në përputhje me ligjin e saj të brendshëm, të ndjekë penalisht atë person, nëse vepra është e dënueshme nga ligji i të dyja palëve kontraktuese, dhe në këtë rast, pala kërkuese i dërgon nëpërmjet rrugëve diplomatike një kërkesë për ndjekje penale të shoqëruar nga dosjet përkatëse dhe dokumentet në zotërim.

Neni 24

Kërkesa dhe dokumentet mbështetëse

1. Kërkesa për ekstradim bëhet me shkrim dhe dërgohet nëpërmjet rrugëve diplomatike me dokumentet e përmendura më poshtë dhe me të dhënat bashkëlidhur:

a) Nëse kërkesa ka lidhje me një person tashmë të dënuar, një kopje zyrtare të vendimit të dënimit të dhënë kundër personit që do të ekstradohet;

b) Urdhri i arrestit ose i mbajtjes nën arrest, ose çdo dokument që ka të njëjtën fuqi, të lëshuar nga një autoritet kompetent, nëse personi që do të ekstradohet është nën hetim;

c) Të dhëna në lidhje me identitetin, përshkrimin dhe një fotografi të personit që do të ekstradohet, nëse është e mundur;

d) Datën, vendin dhe kryerjen e veprave penale për të cilat kërkohet ekstradimi, cilësimi juridik i atyre veprave dhe një kopje e vërtetuar e dispozitave të zbatueshme ligjore.

2. Të gjitha dokumentet e lartpërmendura përkthehen në gjuhën angleze dhe vërtetohen nga pala kërkuese.

Neni 25

Arrestimi i përkohshëm

1. Në rast të një urgjence, autoritetet kompetente të palës kërkuese mund të kërkojnë arrestimin e përkohshëm të personit të kërkuar. Autoritetet kompetente të palës së kërkuar vendosin çështjen në përputhje me ligjin e saj.

2. Kërkesa për arrestimin e përkohshëm përcakton se ekziston një nga dokumentet e përmendura në nenin 24, paragrafi 1(b), dhe se synohet të dërgojë një kërkesë për ekstradim. Ajo deklaron, gjithashtu, se për cilën vepër penale kërkohet ekstradimi dhe kur dhe ku është kryer kjo vepër penale dhe për aq sa është e mundur, jep një përshkrim të personit të kërkuar.

3. Një kërkesë për arrestim të përkohshëm i dërgohet autoriteteve kompetente të palës së kërkuar ose nëpërmjet rrugëve diplomatike, ose drejtpërdrejt me postë, ose telegraf ose përmes Organizatës Ndërkombëtare të Policisë Kriminale (Interpol), ose me ndonjë mjet tjetër që siguron të dhëna me shkrim ose të pranuar nga pala e kërkuar. Autoriteti kërkuës informohet pa vonesë për rezultatin e kërkesës së saj.

4. Arrestimi i përkohshëm mund të përfundojë nëse brenda një periudhe prej 18 ditësh pas arrestimit, pala e kërkuar nuk ka marrë kërkesë për ekstradim dhe dokumentet e përmendura në nenin 24. Në asnjë rast, ajo nuk tejkalon 40 ditë nga data e këtij arrestimi. Mundësia e lirimit me kusht në çdo kohë nuk përjashtohet, por pala e kërkuar merr masat që çmon të nevojshme për të parandaluar arratisjen e personit të kërkuar.

5. Lirimi nuk cenon riarrestimin dhe ekstradimin nëse një kërkesë për ekstradim është marrë më pas.



Neni 26

Informacioni plotësues

Nëse pala e kërkuar ka nevojë për informacion plotësues për të siguruar pajtueshmërinë me kushtet e përfshira në këtë marrëveshje, ajo njofton palën kërkuese nëpërmjet rrugëve diplomatike, para se të kundërshtojë kërkesën dhe mund të vendosë një datë për marrjen e këtyre shpjegimeve/të dhënave.

Neni 27

Kërkesa të njëkohshme

1. Nëse janë bërë shumë kërkesa nga më shumë se një shtet për ekstradim për të njëjtën veprë penale, përparësi do të ketë shteti, siguria e të cilit ose interesi, ose shtetasit, ose interesi i tyre cenohen nga vepra penale dhe më pas shteti në territorin e të cilit është kryer vepra penale dhe në fund shteti nga i cili personi që do të ekstradohet është shtetas.

2. Nëse rrethanat janë identike, atëherë shteti që ka bërë kërkesën i pari ka përparësi. Nëse kërkesat për ekstradim janë për disa vepra penale, atëherë i jepet përparësi rrethanave të veprës penale dhe rrezikshmërisë së saj.

Neni 28

Dorëzimi i pasurisë

1. Në masën e lejuar sipas ligjit të palës së kërkuar dhe në bazë të të drejtave të palëve të treta që respektohen siç duhet, e gjithë pasuria që gjendet në palën e kërkuar që është përfunduar si rezultat i veprës penale ose që mund të kërkohet si provë, nëse pala kërkuese e kërkon këtë, dorëzohet nëse jepet ekstradimi.

2. Me kërkesë të palës kërkuese, pasuria e lartpërmendur mund të dorëzohet në palën kërkuese edhe nëse bihet dakord që ekstradimi të mos kryhet.

3. Kur pasuria e lartpërmendur i nënshtrohet sekuestrimit ose konfiskimit në palën e kërkuar, ajo mund ta mbajë ose ta dorëzojë atë përkohësisht.

4. Kur ligji i palës së kërkuar ose mbrojtja e të drejtave të palëve të treta e kërkojnë këtë, çdo pasuri e dorëzuar në këtë mënyrë i kthehet palës së kërkuar pa pagesë pas përfundimit të procedimeve, nëse ajo palë e kërkon këtë.

Neni 29

Vendimi mbi kërkesën

1. Autoritetet kompetente në secilën palë kontraktuese përcaktojnë kërkesën për ekstradim në përputhje me ligjet në fuqi në kohën e kërkesës.

2. Në rast të miratimit të kërkesës për ekstradim, pala kërkuese njoftohet për datën dhe vendin e ekstradimit.

3. Në rast se kërkesa është refuzuar, pala e kërkuar i komunikon palës kërkuese nëpërmjet rrugëve diplomatike, vendimin e marrë, duke dhënë arsyet në lidhje me të.

4. Sipas dispozitave të paragrafit 5 të këtij neni, nëse personi i kërkuar nuk është dorëzuar në datën e përcaktuar, ai mund të lirohet pas mbarimit të 30 ditëve. Pala e kërkuar mund të refuzojë ekstradimin e tij për të njëjtën veprë penale.

5. Nëse rrethana të jashtëzakonshme e pengojnë një palë kontraktuese të dorëzojë ose të marrë personin e kërkuar brenda kohës së caktuar, ajo njofton palën tjetër kontraktuese para përfundimit të afatit. Në këtë rast, autoritetet kompetente të palës kontraktuese mund të bien dakord për një datë të re dorëzimi.

Neni 30

Shtyrja e dorëzimit ose dorëzimi me kusht

1. Nëse personi që do të ekstradohet është nën hetim ose i nënshtrohet gjyqimit, ose është dënuar në palën e kërkuar për një veprë penale të ndryshme nga ajo për të cilin është kërkuar ekstradimi i tij, atëherë pala e kërkuar vendos mbi kërkesën dhe i komunikon vendimin e marrë palës kërkuese.

2. Nëse kërkesa për ekstradim është miratuar, atëherë dorëzimi i personit përkatës të shtyhet derisa gjykimi i tij në palën e kërkuar të përfundojë dhe dënimi i dhënë të ekzekutohet.

3. Dispozitat e këtij neni nuk përjashtojnë mundësinë e dorëzimit të përkohshëm të personit përkatës për t'u paraqitur pranë autoriteteve gjyqësore të palës kërkuese, me kusht që pala kërkuese të marrë përsipër shprehimisht ta kthejë atë në palën tjetër kontraktuese, pas përfundimit të procedimeve gjyqësore në lidhje me të, në bazë të ligjit të palës së kërkuar.

Neni 31

Rregulli i specialitetit

1. Personi që do të ekstradohet nuk gjykohet ose dënohet në palën kërkuese, përveçse për veprën për të cilën është kërkuar ekstradimi i tij ose vepra penale të lidhura me të, ose vepra penale të kryera pas ekstradimit të tij. Nëse cilësimi i veprës është ndryshuar gjatë procedimeve të marra kundër personit të ekstraduar, ai nuk paditet ose gjykohet, përveç, kur elementet përbërëse të veprës penale në cilësimin e saj të ri, lejojnë ekstradimin në përputhje me dispozitat e kësaj marrëveshjeje.

2. Nëse personi i ekstraduar ka pasur mundësinë për t'u larguar nga territori i palës në të cilën ishte ekstraduar, dhe nuk është larguar brenda 45 ditëve pas lirimit të tij përfundimtar ose është larguar gjatë asaj periudhe, por është kthyer vullnetarisht, ai mund të gjykohet për çdo veprë tjetër penale.

Neni 32

Riekstradimi në një shtet të tretë

1. Pala kontraktuese në të cilën personi është ekstraduar, nuk e ekstradon atë në një shtet të tretë, pa pëlqimin e palës tjetër kontraktuese.

2. Personi mund të ekstradohet në një shtet të tretë nëse ekzistojnë kushtet sipas nenit 31/2.

Neni 33

Procedura

Përveç kur kjo konventë parashikon ndryshe, procedura në lidhje me ekstradimin dhe arrestimin e përkohshëm rregullohet vetëm nga ligji i palës së kërkuar.

Neni 34

Transiti

1. Transiti i një personi i cili është subjekt ekstradimi nga një shtet i tretë nëpërmjet territorit të një pale kontraktuese për në territorin e palës tjetër kontraktuese, jepet me paraqitjen e një kërkesë, me kusht që vepra penale përkatëse të jetë një veprë penale e ekstradueshme sipas nenit 17, dhe që pala kontraktuese së cilës i është kërkuar lejimi i transitit, nuk e konsideron veprën penale brenda objektit të nenit 22.

2. Transiti i një shtetasi të palës së kërkuar mund të refuzohet nëse, sipas mendimit të asaj pale, është i papranueshëm sipas ligjit të saj.



3. Kërkesa për transit duhet të shoqërohet nga dokumentet e përmendura në nenin 24 të kësaj marrëveshjeje.

4. Autorizimi nuk kërkohet kur përdoret transportimi ajror dhe nuk është planifikuar asnjë ulje e një mjeti ajror në territorin e shtetit transit. Në rast të një uljeje të paplanifikuar të një mjeti ajror, pala kërkuuese njofton palën e kërkuar dhe ky njoftim ka fuqinë e një kërkesë për arrestim të përkohshëm, dhe paraqet një kërkesë zyrtare për transit.

Neni 35 **Shpenzimet**

1. Secila palë kontraktuese përballon reciprokisht të gjitha shpenzimet e kërkuara nga ekstradimi i personit përkatës, përveç shpenzimeve të transportit të cilat përballohen nga pala kërkuuese.

2. Pala kërkuuese paguan shpenzimet e kthimit të personit të ekstraduar për në vendin ku ai ishte në kohën e ekstradimit të tij, nëse kryerja e veprës penale nga ana e tij ose bashkëpunimi i tij në të, nuk është provuar.

KAPITULLI III TRANSFERIMI I PERSONAVE TË DËNUAR

Neni 36 **Përkufizimet**

Për qëllim të marrëveshjes:

a) “Vendim” nënkupton një vendim ose urdhër të një gjykate, ose organi gjyqësor që vendos një dënim;

b) “Dënim” nënkupton çdo dënim përfundimtar të dhënë nga gjykatat ose autoritetet gjyqësore të shtetit të dënimit, me anë të vendosjes së një dënimi me heqje lirie, sipas dispozitave të ligjeve të tij përkatëse kombëtare;

c) “Shtetas” nënkupton çdo person që zotëron shtetësinë e secilës palë siç përcaktohet në ligjet e shtetësisë së të dyja palëve të njohura që nga data e kërkesës;

d) “Person i dënuar” nënkupton çdo person të dënuar penalisht nga një dënim me heqje lirie;

e) “Shtet i ekzekutimit” nënkupton shtetin në të cilin personi që transferohet përfundon vuajtjen e dënimit të dhënë; dhe

f) “Shtet i dënimit” nënkupton shtetin në të cilin është dënuar personi që do të transferohet.

Neni 37 **Kuptimi i transferimit**

Personat e dënuar në territorin e secilës palë mund të transferohen në territorin e palës tjetër për të vazhduar vuajtjen e dënimit të dhënë sipas dispozitave të kësaj marrëveshjeje. Kërkesa për transferim bëhet me shkrim nga shteti i dënimit, shteti i ekzekutimit, personi i dënuar ose përfaqësuesi i tij ligjor.

Neni 38 **Kushtet për transferimin**

1. Një person i dënuar mund të transferohet sipas kësaj marrëveshjeje vetëm në bazë të kushteve të mëposhtme:

- a) Personi i dënuar është shtetas i shtetit të ekzekutimit;
 - b) Vendimi është i formës së prerë;
 - c) Në kohën e marrjes së kërkesës për transferim, personi i dënuar ka ende të paktën gjashtë muaj dënim për të kryer ose dënimi është i papërcaktuar;
 - d) Pëlqimi për transferim është dhënë nga personi i dënuar ose, kur në lidhje me moshën ose gjendjen fizike, ose mendore të personit, çdo palë e çmon të nevojshme, nga një person i autorizuar për të vepruar në emër të personit;
 - e) Veprimet ose mosveprimet në bazë të së cilave është dhënë dënimi, përbëjnë vepër penale sipas ligjit të shtetit të ekzekutimit; dhe
 - f) Shtetet e dënimit dhe të ekzekutimit bien dakord për transferimin.
2. Kur personi, për shkak të kushteve të tij mendore, nuk është konsideruar penalisht përgjegjës për kryerjen e veprës penale dhe është shtruar në një spital psikiatrik për trajtim mjekësor, procedura e transferimit të tij, në masën që është e mundur, do të jetë e njëjtë.

Neni 39

Detyrimi për dhënien e informacionit

1. Çdo person i dënuar ndaj të cilit mund të zbatohet kjo marrëveshje, informohet nga shteti i dënimit për përmbajtjen e kësaj marrëveshjeje.
2. Nëse personi i dënuar i ka shprehur interes shtetit të dënimit për transferimin sipas kësaj marrëveshjeje, ai shtet e informon shtetin e ekzekutimit sa më parë që të jetë e mundur.
3. Informacioni do të përfshijë:
 - a) emrin, datën dhe vendin e lindjes të personit të dënuar;
 - b) adresën e personit, nëse ka, në shtetin e ekzekutimit;
 - c) një deklaratë të fakteve mbi të cilat ishte bazuar dënimi; dhe
 - d) natyrën, kohëzgjatjen dhe datën e fillimit të dënimit.
4. Nëse personi i dënuar i ka shprehur interes shtetit të ekzekutimit, shteti i dënimit, me kërkesë, i komunikon atij shteti informacionin e përmendur në paragrafin 3.
5. Personi i dënuar informohet me shkrim për çdo masë të marrë nga shteti i dënimit ose shteti i ekzekutimit, sipas paragrafëve pararendës, si dhe çdo vendim të marrë nga secili shtet mbi një kërkesë për transferim.

Neni 40

Kërkesat dhe përgjigjet

1. Kërkesat për transferim dhe përgjigjet bëhen me shkrim.
2. Kërkesat i drejtohen nga Ministria e Drejtësisë e shtetit kërkues Ministrisë së Drejtësisë të shtetit të kërkuar. Përgjigjet komunikohen nëpërmjet rrugëve të njëjta.
3. Shteti i kërkuar informon menjëherë shtetin kërkues për vendimin e tij nëse do të japë pëlqimin apo jo për transferimin e kërkuar.

Neni 41

Dokumentet e kërkua

1. Nëse kërkohet një transferim, shteti i dënimit i siguron dokumentet e mëposhtme shtetit të ekzekutimit, përveç kur secili shtet ka treguar tashmë që ai nuk do të japë pëlqimin për transferimin:
 - a) një kopje të vendimit dhe ligjit mbi të cilin bazohet;
 - b) një deklaratë që tregon pjesën e dënimit tashmë të kryer, duke përfshirë informacion mbi çdo paraburgim, ulje dënimi dhe çdo faktor tjetër në lidhje me zbatimin e dënimit;



c) një deklaratë që përmban pëlqimin për transferimin e përmendur në nenin 38.1(d); dhe
d) sa herë që është e nevojshme, çdo raport mjekësor ose social mbi personin e dënuar, informacion rreth trajtimit në shtetin e dënimit dhe çdo rekomandim për trajtimin e mëtejshëm të personit në shtetin e ekzekutimit.

2. Shteti i ekzekutimit, nëse kërkohet nga shteti i dënimit, i jep atij dokumentet e mëposhtme:

a) një kopje të ligjit përkatës të shtetit të ekzekutimit i cili parashikon se veprimet ose mosveprimet në bazë të të cilave është vendosur dënimi në shtetin e dënimit, përbën vepër penale sipas ligjit të shtetit të ekzekutimit ose do të përbënte vepër penale nëse ishte kryer në territorin e tij; dhe

b) një deklaratë të efektit ndaj personit të dënuar të çdo ligji ose rregulloreje përkatëse në lidhje me ndalimin e personit në shtetin e ekzekutimit pas transferimit.

3. Çdo shtet mund të kërkojë të pajiset me ndonjë prej dokumenteve ose raporteve të përmendura në paragrafin 1 ose 2 më sipër, para se të bëjë një kërkesë për transferim ose të marrë një vendim nëse bie dakord apo jo me transferimin.

4. Dokumentet që sigurohen nga secili shtet sipas kushteve të marrëveshjes lehtësohen nga formalitetet e legalizimit, përveç rasteve kur është bërë një kërkesë për të kundërtën.

Neni 42

Verifikimi i miratimit

1. Shteti i dënimit garanton që personi të cilit i kërkohet të japë pëlqim për transferimin në pajtim me nenin 38.1(d), e bën këtë vullnetarisht dhe me dijeni të plotë për pasojat ligjore të tij. Procedura për dhënien e pëlqimit rregullohet nga ligji i shtetit të dënimit.

2. Shteti i dënimit i jep mundësinë shtetit të ekzekutimit për të verifikuar, nëpërmjet një konsulli ose personi tjetër të caktuar nga ky shtet për këtë qëllim, që pëlqimi është dhënë në përputhje me kushtet e përcaktuara në paragrafin 1 më sipër.

Neni 43

Dorëzimi i personave të dënuar dhe efekti i transferimit për shtetin e dënimit

1. Dorëzimi i personit të dënuar nga autoriteti përkatës i shtetit të dënimit në autoritetin përkatës të shtetit të ekzekutimit ndodh në një vend që duhet të bihet dakord ndërmjet dy shteteve.

2. Marrja në dorëzim e personit të dënuar nga autoritetet e shtetit të ekzekutimit ka fuqinë e pezullimit të zbatimit të dënimit në shtetin e dënimit.

3. Shteti i dënimit nuk mund të zbatojë më dënimin nëse shteti i ekzekutimit konsideron se zbatimi i dënimit ka përfunduar.

Neni 44

Efekti i transferimit për shtetin e ekzekutimit

1. Autoriteti kompetent i shtetit të ekzekutimit vazhdon zbatimin e dënimit menjëherë ose nëpërmjet një urdhri gjykate ose urdhri administrativ të parashikuar nga ligji i tij, sipas kushteve të përcaktuara në nenin 46.

2. Zbatimi i dënimit rregullohet nga ligji i shtetit të ekzekutimit dhe vetë ai shtet është kompetent për marrjen e të gjitha vendimeve përkatëse.

Neni 45
Zbatimi i dënimit

1. Në bazë të paragrafit 2 të këtij neni, shteti i ekzekutimit është i detyruar ligjërisht nga natyra ligjore dhe kohëzgjatja e dënimit të përcaktuar nga shteti i dënimit.

2. Megjithatë, nëse ky dënim është nga natyra ose kohëzgjatja e tij i papajtueshëm me ligjin e shtetit të ekzekutimit, ose me qëllimet e këtij ligji, ai shtet, me anë të një urdhri gjykate, mund të përshtatë sanksionin me dënimin ose masën e parashkruar nga ligji i tij për një vepër penale të ngjashme. Në lidhje me natyrën e tij, dënimi ose masa, për aq sa është e mundur, i korrespondon atij të vendosur nga dënimi që duhet të zbatohet. Ai nuk e përkeqëson, nga natyra ose kohëzgjatja e tij, sanksionin e vendosur në shtetin e dënimit, as nuk tejkalon maksimumin e parashkruar nga ligji i shtetit të ekzekutimit.

3. Një person i dënuar i transferuar sipas kësaj marrëveshjeje, nuk gjykohet ose dënohet në shtetin e ekzekutimit për veprimet, ose mosveprimet në bazë të të cilave është vendosur dënimin në shtetin e dënimit dhe nuk ndalohet për ato veprime ose mosveprime, përveçse në përputhje me këtë marrëveshje.

Neni 46
Konvertimi i dënimit

1. Në rastin e konvertimit të dënimit, zbatohen procedurat e parashikuara nga ligji i shtetit të ekzekutimit. Gjatë konvertimit të dënimit, autoriteti kompetent:

a) është i detyruar ligjërisht nga konstatimet në lidhje me faktet, në masën që ato shfaqen drejtpërdrejt ose tërthorazi nga vendimi i dhënë në shtetin dënues;

b) nuk mund të konvertojë një sanksion që përfshin heqjen e lirisë deri në një sanksion monetar;

c) zbret periudhën e plotë të heqjes së lirisë së vuajtur nga personi i dënuar; dhe

d) nuk përkeqëson pozicionin penal të personit të dënuar dhe nuk është i detyruar ligjërisht nga minimumi që ligji i shtetit të ekzekutimit mund të japë për veprën ose veprat penale të kryera.

2. Nëse procedura e konvertimit zhvillohet pas transferimit të personit të dënuar, shteti i ekzekutimit e mban atë person nën arrest ose ndryshe garanton praninë e atij personi në shtetin e ekzekutimit në pritje të rezultatit të asaj procedure.

3. Shteti i ekzekutimit informon shtetin e dënimit për synimin e tij për të konvertuar një dënim dhe për rezultatet e konvertimit.

Neni 47
Falja, amnistia, ulja e dënimit

Çdo palë mund të japë falje, amnisti ose ulje të dënimit në përputhje me Kushtetutën e saj ose ligje të tjera.

Neni 48
Rishikimi i vendimit

Vetëm shteti i dënimit ka të drejtën për të vendosur mbi çdo kërkesë për rishikimin e vendimit.



Neni 49

Përfundimi i zbatimit

Shteti i ekzekutimit do të përfundojë zbatimin e dënimit sapo të informohet nga shteti i dënimit në lidhje me ndonjë vendim ose masë si rezultat i së cilës dënimi pushon së qeni i zbatueshëm.

Neni 50

Informacioni mbi zbatimin

Shteti i ekzekutimit i jep informacion shtetit të dënimit në lidhje me zbatimin e dënimit:

- a) kur konsideron se zbatimi i dënimit ka përfunduar;
- b) nëse një person i dënuar është arratisur nga burgu para se zbatimi i dënimit të jetë përfunduar; ose
- c) nëse shteti i dënimit kërkon një raport të posaçëm.

Neni 51

Transiti

1. Nëse një palë hyn në marrëveshje me një shtet të tretë për transferimin e personave të dënuar, pala tjetër bashkëpunon për lehtësimin e kalimit transit nëpërmjet territorit të saj të personave të dënuar që transferohen sipas këtyre marrëveshjeve, me përjashtim të rastit kur ajo mund të refuzojë t'i lejojë kalimin transit një personi të dënuar:

- a) që është një prej shtetasve të vet;
- b) kur vepra penale për të cilën ishte vendosur dënimi, nuk është vepër penale e parashikuar sipas ligjit të vet.

2. Pala që synon të kryejë këtë transferim i jep njoftim paraprak palës tjetër në lidhje me këtë transit.

3. Pala e kërkuar për lejimin e transitit mund të mbajë personin e dënuar nën arrest vetëm për atë kohë që e kërkon kalimi transit përmes territorit të saj.

4. Palës së kërkuar për lejimin e transitit mund t'i kërkohet të japë garanci që personi i dënuar nuk do të ndiqet penalisht, ose, përveç rasteve kur parashikohet në paragrafin pararendës, nuk do të ndalohet apo ndryshe t'i nënshtrohet kufizimit të lirisë së tij në territorin e shtetit transit për ndonjë vepër penale të kryer ose dënim të vendosur para nisjes së tij nga territori i shtetit dënues.

Neni 52

Shpenzimet dhe gjuha

1. Çdo shpenzim i shkaktuar në zbatim të kësaj marrëveshjeje përballohet nga shteti i ekzekutimit, me përjashtim të shpenzimeve të shkaktuara vetëm në territorin e shtetit të dënimit.

2. Kërkesat dhe dokumentet mbështetëse shoqërohen nga një përkthim në një prej gjuhëve zyrtare të palës së kërkuar ose në gjuhën angleze.

Neni 53

Zbatimi i përkohshëm

Kjo marrëveshje është e vlefshme për zbatimin e dënimeve të vendosura para ose pas hyrjes së saj në fuqi.

KAPITULLI IV
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 54

Interpretimi dhe zbatimi

Çdo vështirësi që mund të lindë ndërmjet shteteve kontraktuese në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e dispozitave të kësaj marrëveshjeje, trajtohet dhe zgjidhet nëpërmjet rrugëve diplomatike ose dy autoriteteve qendrore të përcaktuara në nenin 3 të saj.

Neni 55

Hyrja në fuqi

1. Kjo marrëveshje i nënshtrohet ratifikimit në përputhje me procedurat kushtetuese në fuqi në të dyja palët. Ajo hyn në fuqi pas (30) ditësh nga njoftimi i fundit nëpërmjet të cilit secila palë informon tjetrën me shkrim, nëpërmjet kanaleve diplomatike që të gjitha procedurat e nevojshme ligjore për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje janë përmbytur.

2. Kjo marrëveshje vazhdon të mbetet e vlefshme pasi të ketë hyrë në fuqi në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, përveç kur secila palë i jep tjetrës një njoftim me shkrim, nëpërmjet kanaleve diplomatike, për qëllimin e saj për ta përfunduar atë. Ky përfundim hyn në fuqi pas një viti nga data e njoftimit.

Në dëshmi të kësaj, të poshtëshënuarit, duke qenë rregullisht të autorizuar nga qeveritë e tyre përkatëse kanë nënshkruar këtë marrëveshje.

Bërë në dy kopje më 14 mars 2011 në gjuhën shqipe, arabe dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njësoj autentike. Në rast mosmarrëveshjesh në interpretim, mbizotëron teksti në gjuhën angleze.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
MINISTRI I DREJTËSISË
Z. Bujar Nishani

PËR QEVERINË E SHTETIT TË KUVAJTIT
MINISTRI I DREJTËSISË
Gjykatës/Rashed Abdulmuhsin Al-Hammad



LIGJ
Nr. 94/2012

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË
PËR ZGJIDHJEN E BORXHIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË KUNDREJT
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË, LIDHUR ME SHLYERJEN E SHUMAVE NË
LLOGARINË E SHKËMBIMIT TË MALLRAVE NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE ISH-REPUBLIKËS FEDERALE SOCIALISTE TË JUGOSLLAVISË**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për zgjidhjen e borxhit të Republikës së Shqipërisë kundrejt Republikës së Maqedonisë, lidhur me shlyerjen e shumave në llogarinë e shkëmbimit të mallrave ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe ish-Republikës Federale Socialiste të Jugosllavisë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 11.10.2012

**Shpallur me dekretin nr.7795, datë 18.10.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

MARRËVESHJE

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË, MBI SHLYERJEN E BORXHIT TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË KUNDREJT REPUBLIKËS SË MAQEDONISË, NË LIDHJE
ME SHLYERJEN E SHUMAVE NË LLOGARITË E SHKËMBIMIT TË MALLRAVE
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE ISH-REPUBLIKËS FEDERALE
SOCIALISTE TË JUGOSLLAVISË**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Maqedonisë (më poshtë “palët”),

- me synim zbatimin e memorandumit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Bosnjës dhe Hercegovinës, Qeverisë së Republikës së

Maqedonisë, Qeverisë së Republikës së Serbisë, Qeverisë së Republikës së Sllovenisë, Qeverisë së Republikës së Kroacisë dhe Qeverisë së Malit të Zi, për shlyerjen e borxhit të Republikës së Shqipërisë, në lidhje me shlyerjen e shumave në llogaritë e shkëmbimit të mallrave ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe ish-Republikës Federale Socialiste të Jugosllavisë, të nënshkruar më 14 dhjetor 2010 në Tiranë, Shqipëri (më poshtë memorandumit);

- me synim rregullimin përfundimtar të detyrimeve të Republikës së Shqipërisë mbi shumën përfundimtare të shlyerjes, në lidhje me shkëmbimin e mallrave ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe ish-Republikës Federale Socialiste të Jugosllavisë, referuar Republikës së Maqedonisë në pajtim me nenin 4 të memorandumit; dhe

- për të zhvilluar dhe fuqizuar më tej marrëdhëniet reciproke tregtare, financiare dhe ekonomike ndërmjet të dyja vendeve,
kanë rënë dakord si më poshtë:

I. HYRJE

Neni 1

Objekti i marrëveshjes

1. Objekti i kësaj marrëveshjeje është shlyerja e borxhit të Republikës së Shqipërisë ndaj Republikës së Maqedonisë, shumës përfundimtare të shlyerjes, në lidhje me shkëmbimin e mallrave ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe ish-Republikës Federale Socialiste të Jugosllavisë, referuar Republikës së Maqedonisë në bazë të aneksit C të marrëveshjes mbi çështjet e trashëgimisë së ish-Republikës Federale Socialiste të Jugosllavisë.

2. Shuma përfundimtare e shlyerjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë, duke përfshirë interesin e zakonshëm të llogaritur për periudhën nga 31 marsi 2006 deri më 30 shtator 2009, arrin në 1,788,478.82 dollarë kleringu (me fjalë: një milion, shtatëqind e tetëdhjetë e tetë mijë, katërqind e shtatëdhjetë e tetë dhe 82/100 US dollarë kleringu).

3. Shuma e parashikuar në pikën 2 të këtij neni përbën borxhin e Republikës së Shqipërisë kundrejt Republikës së Maqedonisë në dollarë kleringu të datës 30 shtator 2009.

4. Palët bien dakord që borxhi i llogaritur në dollarë kleringu, sipas parashikimit në nenin 1.3 do të konvertohet në borxhin e llogaritur në dollarë të Shteteve të Bashkuara (USD), duke përdorur kursin e këmbimit prej 1 dollar kleringu = 1 USD.

5. Palët bien dakord që pas konvertimit të përmendur në pikën 4 të këtij neni, borxhi i Republikës së Shqipërisë kundrejt Republikës së Maqedonisë që prej datës 30 shtator 2009, është 1,788,478.82USD (me fjalë: një milion, shtatëqind e tetëdhjetë e tetë mijë, katërqind e shtatëdhjetë e tetë dhe 82/100 dollarë të Shteteve të Bashkuara).

II. PARIME TË PËRGJITHSHME, PRIVILEGJE DHE DETYRIME

Neni 2

Shuma e borxhit

Detyrimet e Republikës së Shqipërisë kundrejt Republikës së Maqedonisë arrijnë në 1,788,478.82 dollarë të Shteteve të Bashkuara.

Neni 3

Interesi

Palët bien dakord për kushtet e mëposhtme për shlyerjen e borxhit të Republikës së Shqipërisë kundrejt Republikës së Maqedonisë.



1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje, Ministria e Financave e Shqipërisë në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë do të transferojë në llogarinë e specifikuar paraprakisht nga Ministria e Financave e Republikës së Maqedonisë shumën e plotë në mënyrën e mëposhtme:

- a) Tri pagesa gjysmëvjetore të shumës së principalit më 31 mars dhe 30 shtator të çdo viti, që këtu janë caktuar si data pagese;
- b) Data e parë e pagesës së principalit dhe e interesit është data e pagesës që vjen menjëherë pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje;
- c) Pagesa e interesit për periudhën 1 tetor 2009 deri më 30 shtator 2012 bëhet njëkohësisht me pagesën e parë të principalit dhe interesit.

2. Ministria e Financave e Shqipërisë në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë i paguan Ministrisë së Financave të Republikës së Maqedonisë interesin e zakonshëm, duke filluar nga data 1 tetor 2009 deri në datën e shlyerjes totale të borxhit:

- a) Interesi llogaritet bazuar në numrin aktual të ditëve që kanë kaluar dhe në një vit me 360 ditë;
- b) Norma e zbatueshme e interesit është norma USD LIBOR 6-mujore më 31 mars dhe 30 shtator të çdo viti. Nëse data 31 mars ose 30 shtator bie në një ditë pushimi të një vendi, norma e zbatueshme USD LIBOR është ajo e ditës pararendëse të punës; dhe
- c) Ministria e Financave e Republikës së Maqedonisë i dërgon një njoftim me shkrim Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë në lidhje me llogaritjen e interesit.

3. Interesi i zbatueshëm për pagesat e vonuara të principalit dhe të interesit (interes i vonuar) llogaritet me normën 6-mujore USD LIBOR plus 2% në vit.

Neni 4

Autoritetet kompetente të palëve

Autoritetet kompetente të palëve për zbatimin e kësaj marrëveshjeje janë Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë dhe Ministria e Financave e Republikës së Maqedonisë.

Njoftimet që bëhen në pajtim me këtë marrëveshje adresohen si më poshtë:

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë
Ministria e Financave
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë, Shqipëri
Tel.: +35542228405
Faks: +35542228494
Për Republikën e Maqedonisë
Ministria e Financave e Republikës së Maqedonisë
ul. Mito Hadzivasilev Jasmin br.50, Skopje, Macedonia
Tel.: +38923106144
Faks: +38923106779

Neni 5

Arbitrazhi

Palët zgjidhin çdo mosmarrëveshje që rrjedh nga kjo marrëveshje në mënyrë miqësore.

Nëse një mosmarrëveshje nuk mund të zgjidhet miqësisht, palët bien dakord që mosmarrëveshja të zgjidhet përfundimisht në pajtim me rregullat e arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Paris, nga tre arbitra. Secila palë cakton një arbitër dhe këta dy arbitra caktojnë një arbitër të tretë, shtetas të një shteti të tretë që ka marrëdhënie diplomatike me të dyja palët, si Kryetar të Gjykatës së Arbitrazhit.

Nëse palët nuk arrijnë të caktojnë një anëtar të tretë, Kryetarin e Gjykatës së Arbitrazhit, arbitri i tretë caktohet në pajtim me rregullat e arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Paris.

Vendimi i arbitrazhit është përfundimtar, detyrues për të dyja palët dhe i zbatueshëm brenda kohës së përcaktuar në vendim.

Palët bien dakord që arbitrazhi të zhvillohet në pajtim me procedurën e përcaktuar nga rregullat e arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Paris. Ligji i zbatueshëm është ligji bazë francez.

**Neni 6
Ndryshimet**

Kjo marrëveshje ndryshohet vetëm me pëlqimin me shkrim të të dyja palëve.

III. HYRJA NË FUQI

**Neni 7
Ratifikimi i marrëveshjes**

1. Palët ratifikojnë këtë marrëveshje në pajtim me rregullat dhe rregulloret e tyre të brendshme.

2. Secila palë njofton palën tjetër me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike, për përfundimin e procedurave ligjore të brendshme që kërkohen për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën e punës pas datës së marrjes së njoftimit më të fundit.

3. Kjo marrëveshje qëndron në fuqi deri sa detyrimet që rrjedhin nga kjo marrëveshje të jenë përmbushur plotësisht nga të dyja palët.

Bërë më 2012, në dy kopje origjinale, në gjuhën angleze, ku të dyja origjinalet janë identike.

**VENDIM
Nr. 39/2012**

**PËR ZGJEDHJEN E ZOTIT HYSEN OSMANAJ ANËTAR I KOMISIONIT QENDROR
TË ZGJEDHJEVE**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 14 të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

I. Zoti Hysen Osmanaj zgjidhet anëtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)**

Miratuar në datën 11.10.2012



VENDIM
Nr. 40/2012

**PËR ZGJEDHJEN E ZONJËS VERA SHTJEFNI ANËTARE E KOMISIONIT QENDROR
TË ZGJEDHJEVE**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 14 të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zonja Vera Shtjefni zgjidhet anëtare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

Miratuar në datën 11.10.2012

VENDIM
Nr. 41/2012

**PËR ZGJEDHJEN E ZONJËS ALBANA SHTYLLA ANËTARE E KOMISIONIT QENDROR
TË ZGJEDHJEVE**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 14 të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zonja Albana Shtylla zgjidhet anëtare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

Miratuar në datën 11.10.2012

VENDIM
Nr. 42/2012

**PËR ZGJEDHJEN E ZOTIT DENAR BIBA ANËTAR I KOMISIONIT QENDROR TË
ZGJEDHJEVE**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 14 të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zoti Denar Biba zgjidhet anëtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

Miraturar në datën 11.10.2012

VENDIM
Nr. 43/2012

**PËR ZGJEDHJEN E ZOTIT ILIRIAN MUHO ANËTAR I KOMISIONIT QENDROR TË
ZGJEDHJEVE**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 14 të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Lëvizjes Socialiste për Integrim,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zoti Ilirian Muho zgjidhet anëtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

Miraturar në datën 11.10.2012



VENDIM
Nr. 44/2012

**PËR ZGJEDHJEN E ZOTIT JANI JANI ANËTAR I KOMISIONIT QENDROR TË
ZGJEDHJEVE**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 14 të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Partisë Bashkimi për të Drejtat e Njeriut,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zoti Jani Jani zgjidhet anëtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

Miratuar në datën 11.10.2012

VENDIM
Nr. 45/2012

**PËR ZGJEDHJEN E ZONJËS LEFTERIJE LLESHI (LUZI) KRYETARE E KOMISIONIT
QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 15 të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zonja Lefterije Lleshi (Luzi) zgjidhet Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

Miratuar në datën 11.10.2012

DEKRET
Nr. 7771, datë 1.10.2012

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, të neneve 20 dhe 24 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Kostandina Petraq Grosler
2. Bajana Pandeli Shtëmbari
3. Vangjel Nasho Lena
4. Hysen Zenel Mustafaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET
Nr. 7772, datë 1.10.2012

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 dhe 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Alda Lutfi Balilaj
2. Gentiana Ramazan Basha
3. Ols Skender Hidri
4. Gentiana Dylber Rainbacher (Palloshi)
5. Alban Kleanthi Bezhani
6. Fabiona Kostaq Kavaja

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani



DEKRET
Nr. 7773, datë 8.10.2012

PËR LIRIM AMBASADORI NGA DETYRA

Në mbështetje të nenit 92 shkronja “dh” dhe 93 të Kushtetutës, si dhe të nenit 21 pika 2 të ligjit nr. 9095, datë 3.7.2003 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë“, me propozim të Kryeministrit

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Sejdi Qerimaj, lirohet nga detyra e ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqiptotë të Republikës së Shqipërisë në Misionin e Përherëshëm të Republikës së Shqipërisë pranë Zyrës së Kombeve të Bashkuara dhe Organizatave Ndërkombëtare në Gjenevë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET
Nr. 7774, datë 8.10.2012

PËR EMËRIMIN E REKTORIT TË AKADEMISË SË ARTEVE, SHKODËR

Në mbështetje të nenit 92 shkronja “g” dhe 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të nenit 23 pika 2 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozim të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Zef Çoba, emërohet rektor i Akademisë së Arteve, Shkodër.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET
Nr. 7780, datë 9.10.2012

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c”, dhe 93 të Kushtetutës, si dhe neneve 9, 10 dhe 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Ertan Güner Güngör
2. Shukrane Hamdi Mehmeti (Haxhija)
3. Ardita Rasim Kurtolli-Mehmeti (Kurtolli)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET
Nr. 7781, datë 9.10.2012

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 pika 7, e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar në propozimet e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Shaip Shaban Stublla
2. Byrton Zenel Gavazaj
3. Nexhmedin Mehmet Rashica
4. Kjemal Asan Ahmedi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani



DEKRET
Nr. 7782, datë 10.10.2012

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 dhe 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Desar Ruzhdi Sulejmani
2. Blerina Bajram Mema (Ruçaj)
3. Dhori Aleksandër Lipe
4. Frida Myrteza Thaisen
5. Wendy Flamur Thaisen
6. Natasha Skënder Isaia (Caka)
7. Samantha Aleksandër Isaia
8. Ismete Aleksandër Isaia
9. Mehrvin Aleksandër Isaia
10. Dalina Myfit Gjunksi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET
Nr. 7785, datë 12.10.2012

PËR EMËRIM AMBASADORI

Në mbështetje të neneve 92, shkronja “dh” dhe 93 të Kushtetutës, si dhe të nenit 21, pika 2 të ligjit nr. 9095, datë 3.7.2003 “Për shërbimin e jashtëm të republikës së Shqipërisë”, me propozim të Kryeministrit

DEKRETOJ:

Neni 1

Zonja Filloreta Kodra, emërohet Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiptotë i Republikës së Shqipërisë në Misionin e Përherëshëm të Republikës së Shqipërisë pranë Zyrës së Kombeve të Bashkuar dhe Organizatave të tjera Ndërkombëtare në Gjenevë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

UDHËZIM
Nr. 5341/5, datë 7.9.2012

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË ZYRAVE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të paragrafit 2 të nenit 7 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, neneve 13 pika “c” dhe 71 pika 3 të ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar, Ministri i Drejtësisë dhe Ministri i Financave

UDHËZOJNË:

1. Tarifat për shërbimet e ofruara nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme janë sipas aneksit nr. 1, i cili i bashkëlidhet këtij udhëzimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 2. Tarifat e përcaktuara sipas pikës 1 të këtij udhëzimi arkëtohen nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, me përjashtim të rastit të parashikuar në pikën 3.
 3. Në rastet e shërbimeve sipas pikave 14, 15, 16 të aneksit nr. 1, kur këto shërbime kryhen nëpërmjet noterit, tarifa e shërbimit paguhet pranë noterit dhe ndahet si më poshtë vijon:
 - a) 200 (dyqind) lekë për noterin;
 - b) 100 (njëqind) lekë për mirëmbajtjen e sistemit;
 - c) dhe pjesa e mbetur kalon për llogari të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.
 4. Tarifa e shërbimit paguhet në momentin e paraqitjes së kërkesës për ofrimin e shërbimit nga personi i interesuar ose në momentin e dhënies së pëlqimit për përfitimin e shërbimit nëpërmjet noterit.
 5. Rregullat për kalimin e të ardhurave nga tarifat e shërbimit, nga noteri në llogarinë e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, sipas ndarjes së përcaktuar në pikën 3, përcaktohen me marrëveshje të përbashkët mes Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Dhomës Kombëtare të Noterisë.
 6. Tarifat afishohen në çdo zyrë vendore të regjistrimit të pasurisë së paluajtshme.
 7. Të ardhurat e siguruar nga tarifat e shërbimit derdhen 100% në buxhetin e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, duke filluar nag data 1 janar 2013.
 8. Ngarkohet Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij udhëzimi.
- Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Eduard Halimi

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode



ANEKS Nr. 1

LISTA E SHËRBIMEVE TË OFRUARA NGA ZYRAT E REGJISTRIMIT TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME

	Lloji i shërbimit	Tarifa (lekë)
1	Regjistrimi i akteve noteriale që lidhen ndërmjet zhvilluesit të pronës dhe pronarëve të truallit apo me subjektet e treta.	3,500
2	Regjistrimi i kalimit të pronësisë me anë të ligjit, me vendim të gjykatës, apo të një akti administrativ.	3,500
3	Regjistrimi i pasurisë së paluajtshme të fituar me parashkrim fitues.	3,500
4	Regjistrimi i aktit për kalimin e pronësisë nga përmbaruesi gjyqësor.	3,500
5	Regjistrimi i akteve me të cilat krijohet një shoqëri apo një subjekt tjetër i së drejtës, që ka në pronësi pasuri të paluajtshme apo gëzon të drejta të tjera reale.	3,500
6	Regjistrimi i kontratave të shitjes.	3,500
7	Regjistrimi i kontratës së dhurimit	3,500
8	Regjistrim i deklarates për heqje dorë nga pronësia	800
9	Regjistrimi i kontratës së shkëmbimit.	3,500
10	Regjistrimi i kontratës së qirasë apo të nënqirasë	3,500
11	Regjistrimi i titujve “në përdorim”.	3,500
12	Regjistrim i aktit të trashëgimje	700
13	Kopje te vertetuara të dokumentave tekniko-ligjore, në të cilat bazohet regjistri i pasurive të paluajtshme / faqe	200leke/faqe
14	Konsultim i kartelës së pasurisë dhe të dhënave të tjera të pasurisë së paluajtshme	700
15	Verifikimi online i gjendjes juridike të pronësisë në regjistrin elektronik të pasurive të paluajtshme	600
16	Informacion zyrtar i pasurisë për individët dhe Institucionet	700
17	Lëshim kopje të fragmentit të hartës kadastrale	1,000
18	Lëshim kopje kartelesh të pasurisë	1,000
19	Lëshim vërtetimesh (negativ/pozitiv)	300
20	Dhënie e informacionit koordinativ për çdo pasuri të paluajtshme.	1,000
21	Lëshim certifikatë pronësie	1,500
22	Lëshim vërtetim pronësie	1,500
23	Lëshimi i një certifikate të re kur ka humbur apo është dëmtuar certifikata e marrë.	800
24	Regjistrim i vendimit gjyqësor për vendosjen e masës së sigurimit të padisë	900
25	Regjistrim i kërkesë padisë	900

26	Regjistrim i aktit noterial për pezullimin e veprimeve të regjistrimit	900
27	Regjistrim /ndryshim/ shuarje Servituti	900
28	Regjistrim i kontratës së shitjes, kontratës së shkëmbimit dhe kontratës së dhurimit me rezerve/kusht të pasurisë së paluajtshme	900
29	Regjistrim i të drejtës së parablerjes	900
30	Regjistrim i prokurës	900
31	Korrigjim gabimesh në kartelë	700
32	Korrigjim gabimesh në hartën kadastrale	700
33	Korrigjim gabimesh në certifikatën e pasurisë së paluajtshme	700
34	Kërkesë për regjistrimin e bashkimit, ndarjes apo pjestimit të pasurisë së paluajtshme	700
35	Regjistrimi i kontratës së hipotekës për garantimin e kredisë së dhënë nga banka apo institucion tjetër kredidhënës, për kredi me vlerë deri në 1.000.000 lekë	7,500
36	Regjistrimi i kontratës së hipotekës për garantimin e kredise së dhënë nga banka apo institucion tjetër kredidhënës, për kredi me vlerë 1 000.000 - 10 000 000 lekë	15,000
37	Regjistrimi i kontratës së hipotekës për garantimin e kredisë së dhënë nga banka apo institucion tjetër kredidhënës, për kredi me vlerë mbi 10 000 000 lekë	25,000
38	Regjistrim apo fshirje e kontratave të tjera të hipotekës	1,000
39	Regjistrim apo fshirje e hipotekës ligjore	1,000
40	Regjistrimi i Aktit të Bashkëpronësisë për objektet në bashkëpronësi të detyrueshme	5,000
41	Regjistrimi i objekteve të legalizuara	5,000
42	Regjistrim fillestar i pasurisë së paluajtshme pa rilevim e azhurnim nga ZRPP	5,000
43	Regjistrim fillestar i pasurisë së paluajtshme me rilevim e azhurnim nga ZRPP	8,000
44	Regjistrim fillestar i vecantë i pasurive të paluajtshme në zonat rurale	30,000
45	Kalim i regjistrimit nga regjistrat hipotekore në sistemin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, para ose pas përfundimit të regjistrimit fillestar.	1,000
46	Regjistrimi lejes së ndërtimit	1,000
47	Regjistrimi i përkohshëm i karabinasë	6,500
48	Regjistrimi përfundimtar i ndërtimeve të reja.	6,500
49	Regjistrimi i marrëveshjeve dhe akteve lidhur me kufijtë e pasurive të paluajtshme	2,500
50	Ndryshim kufiri	700
51	Saktësim i kufijve të pasurisë	2,500

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë. Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 23.10.2012
Doli nga shtypi më 23.10.2012

Tirazhi: 1200	Formati: 61x86/8
---------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 40 lekë